

L I G J
Nr.9577, datë 11.7.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për transportin ndërkombëtar rrugor”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4993, datë 25.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Letonisë (më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”) me dëshirën për të nxitur transportin e udhëtarëve dhe mallrave me automjete ndërmjet dhe në transit përmes territoreve të të dy vendeve, kanë rënë dakord si më poshtë:

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Përkufizime

1. Termi “vend amtar” nënkupton territorin e Palës Kontraktuese në të cilën është regjistruar një mjet;
2. Termi “vend pritës” nënkupton territorin e një Pale Kontraktuese në të cilin një mjet përdoret në operimet e transportit, por që është i ndryshëm nga vendi i regjistrimit të mjetit;
3. Termi “transportues” nënkupton çdo person fizik ose juridik, i vendosur në territoret e Palëve Kontraktuese dhe i autorizuar në përputhje me ligjet dhe rregullat përkatëse kombëtare, të kryejë transport ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave.
4. Termi “mjet” nënkupton:
 - a) Në transportin e udhëtarëve çdo mjet motorik rrugor, i cili është përshtatur për transportin e udhëtarëve, ka më shumë se nëntë karrige, përfshirë ndenjësen e shoferit dhe është regjistruar në territorin e një prej Palëve Kontraktuese;
 - b) Në transportin e mallrave, çdo mjet motorik rrugor, i cili është regjistruar në territorin e njëjës Palë Kontraktuese dhe i përshtatur dhe i përdorur normalisht për transportin e mallrave. Për

qëllimet e kësaj Marrëveshjeje termi “mjet” zbatohet gjithashtu për çdo trajler ose gjysmëtrajler, i lidhur me ndonjë automjet pavarësisht vendit të regjistrimit të trajlerit ose gjysmëtrajlerit, si dhe çdo kombinim të mjeteve rrugore.

5. Termi “shërbim i rregullt” nënkupton transportin e udhëtarëve përgjatë linjave dhe në përputhje me orarët e rëna dakord më parë dhe me anë të të cilave udhëtarët mund të merren ose zbriten në stacione të paracaktuara. Këto shërbime të rregullta duhet të vendosen mbi bazën e reciprocitetit. Çdo autoritet kompetent lëshon lejet për seksionin e itinerarit që operohet në territorin e tij.

6. Termi “shërbimet vajtje-ardhje” nënkupton shërbimet përmes së cilave, nëpërmjet udhëtimeve të përsëritura në vajtje dhe kthim, grupet e udhëtarëve të mbledhur më parë transportohen nga një vend i vetëm nisjeje në një vend të vetëm destinacioni.

Çdo grup, që përbëhet nga udhëtarë të cilët bëjnë udhëtimin në vajtje, kthehet mbrapsht në vendin e nisjes gjatë një udhëtimi të mëvonshëm.

7. Termi “shërbim i rastit” nënkupton një shërbim i cili nuk bie as brenda përkufizimit të një shërbimi të rregullt, as brenda përkufizimit të një shërbimi vajtje-ardhje.

Neni 2

Qëllimi

Kjo Marrëveshje zbatohet për operimet e transportit ndërkombëtar rrugor të kryera nga transportuesi, i cili në vendin e tij amtar, në përputhje me legjislacionin kombëtar, i është dhënë e drejta të kryejë operime të transportit ndërkombëtar rrugor, me qira dhe shpërblim ose për llogari të vet, dhe mund të kryejë operime të tilla për në, nga, ose në transit nëpërmjet territorit të vendit tjetër.

Neni 3

Përputhja me legjislacionin kombëtar

Transportuesi dhe stafi i tyre duhet t’u binden ligjeve dhe dispozitave kombëtare në fuqi në territorin e vendit pritës, ndërsa kryejnë operimet e transportit rrugor brenda territorit të vendit pritës.

Neni 4

Komiteti i përbashkët dhe autoritetet kompetente

1. Për aplikimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të të dyja Palëve krijojnë një komitet të përbashkët, i cili formohet nga delegatë të caktuar nga këto autoritete.

2. Ky komitet i përbashkët takohet me kërkesën e autoriteteve kompetente të njëres Palë Kontraktuese në takime të cilat do të mbahen të alternuara në territoret e Palëve Kontraktuese.

3. Në këtë Marrëveshje, autoritetet kompetente janë:

- Për Republikën e Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;

- Për Republikën e Letonisë, Ministria e Transportit.

II. Transporti i Udhëtarëve

Neni 5

Autorizimi

Operimet e transportit të udhëtarëve me automjete ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese dhe në transit ndërmjet tyre që përmenden në nenin 6 duhet të kenë autorizimin përkatës të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit pritës.

Neni 6

Shërbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje

1. Shërbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje, të kryera ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese ose në transit nëpërmjet tyre, aprovohen më përpara bashkërisht nga autoritetet e tyre kompetente.

2. Transportuesit duhet t'i adresojnë kërkesat për autorizime për shërbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje tek autoritetet kompetente të vendit të tyre amtar. Në qoftë se autoriteti kompetent aprovon kërkesën, ai e përcjell kërkesën në fjalë tek autoriteti kompetent i vendit pritës së bashku me një rekomandim.

3. Komiteti i përbashkët duhet:

a) të vendosë kushtet dhe kërkesat që duhet të plotësohen nga kërkesat;

b) të përcaktojë konceptet e vendit të nisjes dhe destinacionit në shërbimet vajtje-ardhje.

Neni 7

Shërbimet e rastit

Ndërsa kryejnë shërbimet e rastit, transportuesit të cilët janë të regjistruar në territoret e secilës Palë Kontraktuese duhet t'u binden dispozitave të Marrëveshjes mbi Transportin Ndërkombëtar të Rastit të Udhëtarëve me Autobuz (Marrëveshjes Intebus).

III. Transporti i mallrave

Neni 8

Regjimi i lejeve

1. Transportuesit mund, nëpërmjet lejeve të siguruara paraprakisht të lëshuara nga autoriteti kompetent të vendit pritës, të kryejnë transport mallrash ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese, vetëm nëse vendoset ndryshe nga komiteti i përbashkët. Transporti transit i mallrave ndërmjet tyre do të kryhet pa leje.

2. Transportuesit mund të kryejnë transport mallrash ndërmjet territorit të vendit pritës dhe vendeve të treta vetëm në qoftë se ata kanë siguruar paraprakisht leje të lëshuara nga autoriteti kompetent i vendit pritës.

3. Leja përdoret vetëm nga transportuesi për të cilin është lëshuar dhe nuk është e transferueshme. Leja duhet të mbahet në mjet gjatë gjithë udhëtimit dhe duhet të paraqitet me kërkesën e ndonjë zyrtari të autorizuar kontrolli.

4. Autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese shkëmbejnë çdo vit një numër të aprovuar bashkërisht të lejeve të transportit të mallrave.

Neni 9

Përfshirja nga kërkesat e lejeve

1. Kategoritë e mëposhtme të transportit përfshihen nga kërkesat për leje:

a) transporti me mjete, pesha e ngarkuar totale e lejueshme (TPLW) e të cilave nuk i kalon 6 tonët, ose kur ngarkesa e lejuar, përfshirë trajlerat, nuk i kalon 3.5 tonët;

b) transporti i mjeteve të cilat janë dëmtuar ose shkatërruar dhe transporti i mjeteve për riparimin e dëmtimeve;

c) udhëtimet pa ngarkesë të një mjeti mallrash i dërguar për të zëvendësuar një mjet i cili është dëmtuar në vend tjetër dhe gjithashtu udhëtimi i kthimit, pas riparimit të mjetit që është dëmtuar;

d) transporti i furnizimeve dhe pajisjeve mjekësore të nevojshme për emergjencat, veçanërisht në përgjigje të katastrofave natyrore dhe ndihmës humanitare;

e) transporti i punimeve dhe veprave të artit për panairë dhe ekspozita për qëllime jotregtare;

f) transporti për qëllime jotregtare të rekuizitave, pajisjeve shtesë dhe kafshëve për në ose nga shfaqjet teatrale, muzikore, filmike, sporteve ose cirku, panairëve ose festave dhe të atyre të caktuara për regjistrime radioje ose për filma ose xhirime televizive;

g) udhëtimi i parë pa ngarkesë i automjeteve të sapoblera.

2. Komitetit të Përbashkët i jepet e drejta të ndryshojë listën e kategorive të transportit të përjashtuara nga kërkesat për leje të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit në fjalë dhe të bien dakord për dokumentet që duhet të mbahen në bord kur kryhen transportet e lartpërmendura.

IV. Dispozita të tjera

Neni 10 **Kabotazhi**

Transportuesit nuk mund të kryejnë transport kabotazhi në territorin e vendit pritës.

Neni 11 **Shkeljet**

1. Në rast se një transportues ose stafi në bordin e një mjeti të regjistruar në një Palë Kontraktuese nuk ka respektuar legjislacionin në fuqi në territorin e vendit pritës ose dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ose kushtet e përmendura në leje, autoriteti kompetent i vendit amtar mundet, me kërkesë të autoritetit kompetent të vendit pritës, të ndërmarrë masat e mëposhtme:

a) të lëshojë një paralajmërim për transportuesin e cili kreu shkeljen;
b) të anulojë ose të tërheqë përkohësisht lejet që lejojnë transportuesin të kryejë transporte në territorin e Palës Kontraktuese ku u krye shkelja.

2. Autoriteti kompetent, i cili ka miratuar një masë të tillë, ia njofton atë autoritetit kompetent të vendit pritës që e ka propozuar atë.

3. Dispozitat e këtij neni nuk përjashtojnë sanksionet ligjore të cilat mund të zbatohen nga gjykatat ose autoritetet administrative të vendit ku u krye shkelja.

Neni 12 **Taksimi**

1. Mjetet të cilat janë të regjistruara në territorin e një Pale Kontraktuese dhe janë përkohësisht të importuara në territorin e vendit pritës për të kryer shërbimet e transportit në përputhje me këtë Marrëveshje, përjashtohen, sipas parimit të reciprocitetit, nga taksat dhe detyrimet të vëna mbi qarkullimin ose zotërimin e mjeteve dhe nga taksat dhe detyrimet e vëna mbi operimet e transportit të kryera në territorin e vendit pritës.

2. Megjithatë ky përjashtim nuk zbatohet për pagesat e taksave rrugore, taksat e urave dhe detyrimet e tjera të ngjashme, të cilat kërkojnë gjithmonë mbi bazën e parimit të mosdiskriminimit.

3. Mbi mjetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, detyrimet doganore përjashtohen mbi:

a) mjetet;
b) lubrifikantët dhe karburantin që ndodhet në serbatorët e zakonshëm të furnizimit të mjeteve dhe në serbatorët për pajisjet ftohëse;
c) pjesët e ndërrimit të importura në territorin e vendit pritës, të parashikuara për shërbimin e riparimit të një mjeti. Pjesët e zëvendësuara do të rieksporthen ose shkatërrohen nën kujdesin e autoriteteve kompetente doganore.

Neni 13 **Mallrat e rrezikshme**

Kur kryhet transport ndërkombëtar i mallrave të rrezikshme, transportuesit të cilët janë regjistruar në territoret e njërës nga Palët Kontraktuese duhet t'u binden dispozitave të Marrëveshjes Europiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR).

Neni 14

Peshat dhe përmasat

1. Në lidhje me peshat dhe përmasat e mjeteve, çdo Palë Kontraktuese ndërmerr të mos vendosë mbi mjetet e regjistruara në territorin e Palës tjetër Kontraktuese kushte, të cilat janë më të kufizuara sesa ato të vendosura mbi mjetet e regjistruara brenda territorit të tij të vet.

2. Në qoftë se peshat dhe përmasat e mjetit me ose pa ngarkesë e përdorur në operimet e transportit i kalon limitet maksimale të lejueshme që janë në fuqi në territorin e vendit pritës, është e nevojshme të lëshohet një leje speciale nga autoritetet kompetente të atij vendi.

Transportuesit duhet t'u binden kërkesave të specifikuara në një leje të tillë.

Neni 15

Detyrimet ndërkombëtare

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk ndikojnë mbi të drejtat ose detyrimet e Palëve Kontraktuese të përfshira në konventat ndërkombëtare, marrëveshjet dhe rregulloret të cilat zbatohen për ata.

Neni 16

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Marrëveshja zbatohet përkohësisht nga data e firmosjes së saj dhe hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet kanaleve diplomatike, nëpërmjet të cilave Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën që kushtet e kërkuara nga legjislacionet e tyre respektive kombëtare për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë plotësuar.

2. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe, me përjashtim të rasteve nëse ajo denoncohet nga njëra prej Palëve Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në atë rast, Marrëveshja përfundon gjashtë muaj pasi Pala tjetër Kontraktuese ka njoftuar për këtë.

Bërë në dy kopje origjinale në Rigë, më 28 mars 2006, secila në gjuhën shqipe, letoneze dhe angleze, çdo tekst duke qenë autentikisht i barabartë. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze ka përparësi.